



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 139, Datë 24.09.2019

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE DHE
NDRYSHIMEVE NË VENDIMIN NR. 190, DATË 23.11.2017 “MBI MIRATIMIN E
RREGULLORES PËR PËRCAKTIMIN E PAGESAVE TË RREGULLIMIT PËR TË
LICENCUARIT NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE”.**

Në mbështetje të nenit 16 dhe neni 17, pika 4, të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar; nenit 14 të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar, nenit 15 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurat e ERE”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 03.09.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 24.09.2019, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 79/2 Prot, datë 22.08.2019, të përgatitur nga grupi i punës, mbi propozimin për fillimin e procedurës për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në vendimin e bordit të ERE nr. 190, datë 23.11.2017 “Mbi miratimin e rregullores për përcaktimin e pagesave të rregullimit për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”,

Konstatohet se:

- Neni 17, pika 4 e Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë elektrike”, i ndryshuar, ngarkon ERE-n me detyrimin për përcaktimin dhe miratimin e pagesave rregullatore që paguhen prej të licencuarve, në përputhje me rregulloren përkatëse si dhe pagesa duhet të jetë në përpjesëtim të drejtë me të ardhurat vjetore që vijnë nga veprimtaria e licencuar.
- Neni 14 i Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” i ndryshuar, ngarkon ERE-n me detyrimin për përcaktimin dhe miratimin e pagesave të aplikimit për licencë dhe pagesave rregullatore për të licencuarit në sektorin e gazit natyror, në përputhje me metodologjinë e miratuar prej saj.
- Objektivi i rregullores për përcaktimin e pagesave të rregullimit për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike është, të përcaktojë pagesa rregullimi të veçanta në respekt të përcaktimeve të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë elektrike”, i ndryshuar, për të gjithë të licencuarit në aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes, operimit të sistemeve të mbyllura të shpërndarjes, furnizimit, tregtimit dhe operimit të tregut të energjisë elektrike dhe përcaktimeve të Ligjit Nr. 102/2015, Për Sektorin e Gazit Natyror” i ndryshuar, për të gjithë të licencuarit në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror, shpërndarjes së gazit natyror, furnizimit të gazit natyror, tregtimit të gazit

natyror, operimit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror, operim në impiantet e GNL-së; funksionimin e operatorit të tregut të gazit natyror.

- Në nenin 5.3 të kësaj rregulloreje për përcaktimin e pagesave të rregullimit për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike parashikohet se: *5.3 Pagesa duhet të jetë në përputhje të drejtë me të ardhurat vjetore që vijnë nga veprimtaria e licencuar.*
- Në nenin 3 pika 52 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, parashikohet se: *52, “Pagesa rregullatore” është pagesa vjetore që të gjitha shoqëritë e licencuara në sektorin e energjisë elektrike paguajnë për llogari të ERE-s, për të mbuluar kostot e veprimtarisë rregullatore të tij. Pagesa rregullatore për çdo shoqëri të licencuar miratohet çdo vit nga ana e ERE-s, në bazë të një metodologjie të miratuar nga ky institucion.*
- Në nenin 4 pika 69 të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” i ndryshuar, parashikohet se *“Pagesa rregullatore” është pagesa vjetore që shoqëritë e licencuara në sektorin e gazit natyror paguajnë në ERE për të mbuluar kostot e veprimtarisë rregullatore të tij, në bazë të një metodologjie të miratuar nga ERE.*
- Në kuptim të përcaktimeve të mësipërme, konstatohet që shoqëritë e licencuara në sektorin e energjisë, paguajnë për llogari të ERE-s pagesën rregullatore, për të mbuluar kostot e veprimtarisë rregullatore.

Kostot e veprimtarisë rregullatore të ERE-s lidhen me zbatimin e objektit të punës së institucionit, që referuar akteve nënligjore të miratuara në zbatim të Ligjit nr. 43/2015 *Për Sektorin e Energjisë Elektrike*” i ndryshuar dhe Ligjit Nr. 102/2015, *Për Sektorin e Gazit Natyror*” i ndryshuar kanë të bëjnë kryesisht me:

- Marrjen e vendimeve, të cilat janë të detyrueshme për zbatim nga të gjithë të licencuarit që veprojnë në sektorin e energjisë;
- Përcaktimin e rregullave dhe kërkesave për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë;
- Miratimin e tarifave të përkohshme transmetimi, në rastet kur operatorët e transmetimit ose shpërndarjes krijojnë vonesa në ndryshimin e tarifave.
- Monitorimin dhe kontrollin e funksionimit të tregut të energjisë dhe marrjen e masave të nevojshme për nxitjen e konkurrencës efektive dhe sigurinë e funksionimit të tregut;
- Kërkimin e informacioneve prej të licencuarve, në kuadër të realizimit të detyrave të tyre;
- Vendosijen e masave administrative efektive, proporcionale dhe parandaluese ndaj të licencuarve;
- Shqyrtimin dhe miratimin në përputhje me parimin e planifikimit me koston më të ulët, planet e investimeve të operatorëve të transmetimit dhe shpërndarjes dhe monitoron

- zbatimin e tyre;
- Zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, në lidhje me ankesat e paraqitura nga klientët dhe mosmarrëveshjet e lindura midis të licencuarve, sipas parashikimeve të ligjit;
 - Monitorimin e zbatimitin e kontratave të lidhura midis të licensuarve duke ushtruar të drejtën aksesit mbi dokumentacionin dhe informacionin e të licencuarit dhe duke ruajtur konfidencialitetin e informacionit të marrë, etj..
 - Në zbatim të detyrave si më sipër, është konstatuar një rritje e volumit të aktivitetit të vetë rregullatorit me qëllim trajtimin e problematikave të të licencuarve, vendimmarrjet e bordit për një sërë çështjesh që lidhen kryesisht me rregullimin e sektorit dhe të veprimtarisë së të licencuarve, monitorimin e aktivitetit të këtyre të fundit por edhe trajtimin të praktikave që lidhen me shqyrtimin e legjitimitetit të marrdhënieve kontraktuale mes të licencuarve.
 - Duke filluar nga viti 2017, pas vendimmarrjes së bordit të ERE nr. 190, datë 23.11.2017, mbi miratimin e rregullores për përcaktimin e pagesave të rregullimit për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike, pjesën më të madhe të aktivitetit rregullator të ERE e zë rregullimi i operatorëve publike, në kuptim të të ngarkuave me detyrimin e shërbimit publik që mbështetur në parashikimet e VKM nr. 244/2016 janë KESH sh.a., OSHEE sh.a. dhe OST sh.a. si dhe shoqërisë Albgaz sh.a. si një shoqëri e rregulluar e cila ushtron aktivitetin e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror në mbështetje të parashikimeve të VKM nr. 848, datë 07.12.2016.
 - **Në analizë të të dhënave që lidhen me vendimmarrjet e bordit të ERE-s sipas periudhave respektive në vijim të vendimit nr. 190, datë 23.11.2017 e që kanë të bëjnë me ushtrimin e aktiviteti rregullator si vendimmarrje të bordit të ERE, seanca dëgjimore, monitorime dhe korrespondenca për/me të ngarkuarit me detyrimin e shërbimit publik, zënë pjesën më të madhe të veprimtarisë rregullatore të ERE :**
 - Neni 6.1 i vendimit të bordit të ERE “Mbi miratimin e rregullores për përcaktimin e pagesave të rregullimit për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike nr. 190, datë 23.11.2017 parashikon se : Pagesat rregullatore do të llogariten bazuar në peshën specifike që zënë të ardhurat e realizuara në vitin paraardhës nga aktiviteti i çdo të licensuari ndaj totalit të të ardhurave të sektorit të energjisë elektrike.
 - Neni 6.2 i vendimit të bordit të ERE, Mbi miratimin e rregullores për përcaktimin e pagesave të rregullimit për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike nr. 190, datë 23.11.2017 parashikon se:Pagesa rregullatore për secilin të licensuar është e barabartë me produktin e peshës specifike të llogaritur sipas pikës 6.1 me vleftën për t’u shpërndarë, buxhetin e ERE-s (pasi të jenë zbritur pagesat fikse nga licencimi) të përcaktuar sipas pikës 1 të nenit 17 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.
 - Neni 6.3 i vendimit të bordit të ERE nr. 190, datë 23.11.2017, Mbi miratimin e rregullores për përcaktimin e pagesave të rregullimit për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike parashikon se :Për shoqëritë e licencuara në aktivitetin e prodhimit,

furnizimit dhe tregimit të energjisë elektrike që në vitin paraardhës nuk kanë pasur aktivitet, pagesa rregullatore do të jetë një shumë fikse prej 40 mijë lekësh.

- Duke vlerësuar se për ushtrimin e veprimtarisë rregullatore të ERE me qëllim rregullimin e veprimtarisë së të licencuarve të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, pesha specifike që zënë këta të fundit për efekt të rregullimit të tyre është ndjeshëm më e madhe se ajo e çdo të licencuari tjetër në sektorin e energjisë elektrike dhe gazi natyror.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurës për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e bordit të ERE nr. 190, datë 23.11.2017, “Mbi miratimin e rregullores për përcaktimin e pagesave të rregullimit për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike, si më poshtë :
 - a. Neni 1 bëhet: Rregullorja për përcaktimin e pagesave të rregullimit për të gjithë të licencuarit e tregut të energjisë elektrike dhe gazit natyror nga Enti Rregullator i Energjise, është hartuar në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” I ndryshuar dhe Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e gazit natyror”, I ndryshuar.
 - b. Kudo në rregullore, togfjalëshi energjisë elektrike, bëhet energjisë.
 - c. Neni 3 bëhet : Objektivi i kësaj rregulloreje të llogaritjes së pagesave rregullatore është, të përcaktojë pagesa rregullimi të veçanta për të gjithë të licencuarit në aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes, operimit të sistemeve të mbyllura të shpërndarjes, furnizimit, tregimit dhe operimit të tregut të energjisë elektrike dhe për të gjithë të licencuarit në aktivitetin e transmetim të gazit natyror, shpërndarjes së gazit natyror, furnizimit të gazit natyror, tregimit të gazit natyror, operimit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror, operim në impiantet e GNL-së; funksionimin e operatorit të tregut të gazit natyror.
 - d. Në nenin 4 shtohet pika 4.4 me përmbajtje: tregut të energjisë do të thotë tregut të energjisë elektrike dhe atij të gazit natyror në kuptim të Ligjit nr. 43/2015 *Për sektorin e energjisë elektrike, I ndryshuar* dhe ligjit nr. 102/2015 *Për sektorin e gazit natyror, I ndryshuar*.
 - e. Neni 5, pika 5.1 ndryshon: Kjo Rregullore është konceptuar konform nenit 17 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, I ndryshuar dhe nenit 14 të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, I ndryshuar, ku parashikohet se:
 - f. Neni 5.4 ndryshon: Të licencuarit në zbatim të neneve 45 e 46 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, I ndryshuar dhe nenit 30 të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, I ndryshuar dhe të kushteve të licencës depozitojnë në ERE deri më datë 31 Janar të vitit pasardhës pasqyra të plota për vitin e mëparshëm ushtrimor e më tej deri në datë 30 Qershor kopje të audituar të pasqyrave financiare të periudhës së mëparshme nga ku rezulton informacioni mbi të ardhurat e realizuara nga aktiviteti i licencuar që do të përdoren në llogaritjen e pagesave të rregullimit.

- g. Neni 6.1 ndryshon: Pagesat rregullatore do të llogariten bazuar në peshën specifike të aktivitetit Rregullator të ERE-s, për çdo vit ushtrimor, për të ngarkuarit me shërbimin publik të realizuara në vitin paraardhës nga aktiviteti i çdo të licencuari ndaj totalit të të ardhurave të sektorit të energjisë elektrike.
 - h. Neni 6.2 ndryshon: Pagesa rregullatore për secilin të licencuar është e barabartë me produktin e peshës specifike të llogaritur sipas pikës 6.1 me vleftën për t'u shpërndarë, buxhetin e ERE-s (pasi të jenë zbritur pagesat fikse nga licencimi) të përcaktuar sipas pikës 1 të nenit 17 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.
 - i. Neni 6.3 ndryshon: Për shoqëritë e licencuara në aktivitetin e prodhimit, furnizimit dhe tregtimit të energjisë elektrike që në vitin parardhës nuk kanë pasur aktivitet, pagesa rregullatore do të jetë një shumë fikse prej 100 mijë lekësh.
 - j. Neni 9.1 ndryshon : Në rast se i licencuari nuk bën pagesën rregullatore brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit, ndaj tij zbatohen sanksione në përputhje me nenin 107 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, I ndryshuar dhe nenit 27 gërma ç të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, I ndryshuar.
 - k. Neni 9.2 ndryshon : Refuzimi i paraqitjes së pasqyrave financiare në kohë ose dërgimi me vonesë i tyre përbëjnë kundravajte administrative dhe ndëshkohen sipas pikës 1 (b) nenit 107 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe pikës ii) të nenit 106 të Ligjit Nr. 102/2015 Për Sektorin e Gazit Natyror.
 - l. Neni 9.3 ndryshon: Në rast se i licencuari nuk përmbush detyrimin për kryerjen e pagesës rregullatore edhe pas masës së marrë sipas pikës 9.1. e 9.2 të këtij neni, atëherë ndaj tij Bordi mund të fillojë procedurat për heqjen e licencës, siç përcaktuar në pikën 1 (ç) të nenit 42 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për sektorin e Energjisë Elektrike”.
2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brënda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETARI

Petrit Ahmeti